

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

Një ndaluar nga OKB/ Ambasadorja e Ukrainës në SHBA: Rusia ka përdorur bombë me vakum

2

Kush është Zonja e Parë e Ukrainës, mbështetja ndaj bashkëshortit dhe ndikimi në vend

3

Zelensky firmos urdhrin: Çdo i huaj që kërkon të luftojë në Ukrainë s'ka nevojë për vizë! Rusia po bën

4

Mero Baze: Koha të 'falenderojmë' Vladimir Putinin!

5

Nata e pestë e luftimeve, Kievin nën sulm të pandalshëm, autokolonë gjigante 65 km drejt kryeqytetit!

OKB: 520 mijë ukrainas kanë lënë shtëpitë! Zelensky: S'ka viza për ata që luftojnë për ne

Kronikë

Qëlloi me kallashnikov në ajër, arrestohet 29-vjeçari në Kuçovë! Një 21-vjeçar nën hetim pasi iu gjet kanabis në shtëpi

Një 29-vjeçar është arrestuar nga policia në Kuçovë pasi ka qëlluar me kallashnikov në ajër ndërsa një 21-vjeçar është nën hetim pasi në shtëpi iu gjet kanabis.



[Sh].com

Redaksia

28 Shkurt, 09:52 | Përditësimi i fundit: 28 Shkurt, 09:59

A

A

Policia e Beratit në kuadër të operacionit të koduar 'Mesnata', ka arrestuar një 29-vjeçar ndërsa një tjetër është nën hetim. Mësohet se Franko Brisku është arrestuar nga blutë e qytetit pasi në ka qëlluar me armë zjarri në ajër në Kuçovë.

Sipas raportimeve, në banesën e 29-vjeçarit policia ka sekuestruar një armë zjarri kallashnikov, granatë ofensive dhe fishekë luftarakë.

[Sh].com

LEXO EDHE:

Arrestohet 52-vjeçari në Kamëz, policia i gjen një pistoletë dhe 173 fishekë në shtëpi

Në kuadër të këtij operacioni, Kastriot Lezo, 21 vjeç është nën hetim nga autoritetet pasi gjatë kontrollit në banesën e tij, u gjetën dhe u sekuestruan një sasi lënde narkotike, kanabis sattiva dhe disa fishekë luftarakë.

Njoftimi i Policisë

Finalizohet me sukses operacioni policor i koduar "MESNATA", për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje dhe lëndëve narkotike. Operacioni u realizua si rezultat i punës së Komisarariatit të Policisë Kuçovë në bashkëpunim me DVP Berat.

Qëlloi me armë zjarri në ajër, kapet dhe vihet në pranga autori. Gjithashtu u sekuestrua një armë zjarri e tipit Kallashnikov, një granatë ofensive dhe fishekë luftarakë. Në vijim u procedua dhe një shtetas tjetër pasi shërbimet e policisë i gjetën në banesë një sasi lënde narkotike e llojit Cannabis Sativa dhe disa fishekë luftarakë.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kuçovë, pas njoftimit të marrë për të shtëna me armë në periferi të Kuçovës, kanë organizuar punën për kapjen e autorit.

Sapo u morën informacionet në rrugë operative, shërbimet e Policisë organizuan dhe zhvilluan operacionin policor të koduar "MESNATA", ku është bërë e mundur kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit F. B., 29 vjeç, banues në lagjen "11 Janari", Kuçovë.

Gjatë kontrollit në oborrin e banesës së tij u gjetën dhe u sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri e tipit Kallashnikov, një granatë ofensive dhe fishekë luftarakë.

Gjithashtu, në kuadër të këtij operacioni, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kuçovë në bashkëpunim me Seksionin për Hetimin e Narkotikëve në DVP Berat, proceduan penalisht shtetasin K.L., 21 vjeç, banues në lagjen "11 Shkurti", Kuçovë, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij u gjetën dhe u sekuestruan një sasi lënde narkotike e llojit Cannabis Sativa dhe disa fishekë luftarakë. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat për veprime të mëtejshme.

M.Ç/Shqiptarja.com

TAG:

Arrestime

policia berat

Berat

Komento

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:

Jeni dakord me sanksionet e vendosura nga Shqipëria ndaj Rusisë?

PO

JO

NUK E DI

Lajme të tjera

Sociale

Dimal, 150 banorë të Sheqit pa shërbim mjekësor! Banorët udhëtojnë mbi 20 kilometra për të kryer një vizitë mjekësore

Mimoza Sinanaj

28 Shkurt, 08:43

Sociale

Jeta në mjerim e familjes me 10 anëtarë në Dimal, kryefamiljarja: Fëmijët flenë në tokë, s'kemi ndihmë! As bukë nuk na japin është mbushur lista

26 Shkurt, 22:30

Kronikë

E fundit/ FNSH dhe 'Shqiponjat' pika kontrolli dhe patrullime në Elbasan, Berat e Vlorë në 'sitë' automjete të ndryshme

26 Shkurt, 18:46

Kronikë

Trafikonin makina të vjedhura nga Kosova drejt Shqipërisë, arrestohen 7 persona, mes tyre 3 policë / Emrat dhe rolet

26 Shkurt, 11:31

Kronikë

Tentuan të trafikojnë 6.5 kg kanabis në Korfuz, arrestohen dy të rinj, shpallet në kërkim një tjetër (EMRAT)

25 Shkurt, 13:53

Kronikë

Kanabis në xhep, dhunë në familje dhe të dehur në timon, 6 të arrestuar në Tiranë! Nën hetim 4 të tjerë, ja për çfarë akuzohen

25 Shkurt, 12:57

Kronikë

Mori kredi në emër të dikujt tjetër me dokumente false, nën hetim 37-vjeçarja në Vlorë! Pranga 45-vjeçarit që dhunoi të bijën e mitur

25 Shkurt, 12:44

Kronikë

Po pinte kafe në lokal, qëllohet me sopatë pas kurrizit 26-vjeçari në Vlorë! Policia e dërgon në spital

25 Shkurt, 11:59

Kronikë

Fikën serverin sapo hyri policia, arrestohen tre të rinjtë që mashtronin të huajt përmes Call Center-it në Tiranë

25 Shkurt, 10:45

Kronikë

Katër të arrestuar për kultivim kanabisi në Mat, dy në kërkim! Një tjetër në pranga për dhunë në familje

24 Shkurt, 14:32

Kronikë

Plagosën me thikë tre vajza pas një sherri, arrestohen dy të reja në Tiranë

24 Shkurt, 13:55

Kronikë

Dy kallashnikovë, një pistoletë dhe 4 kg kanabis në banesë, arrestohet 32-vjeçari në Vlorë

24 Shkurt, 13:21

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje